

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI I GJEOGRAFISË

KLASA VI

Tiranë, 2005

HYRJE

Objekti i studimit dhe qëllimet e përgjithshme

Themelore për lëndën e gjeografisë në asimin e detyruar është puna për formimin e këndvështrimeve holistike për botën që na rrethon, ku konceptet dhe faktet qendrore janë të gërshetuara në kontekste më të mëdha.

Si e tillë, lënda na jep mundësi për të përfituar dije dhe përvoja të reja nëpërmjet vëzhgimit, testim, kërkimit, investigimit dhe krijimit. Mësimdhënia e gjeografisë, është, gjithashtu, një mundësi për dhënien e argumenteve e shprehjen e pikëpamjeve vetjake në forma të ndryshme, me gojë e me shkrim. Në dialog me të tjerët mund të dallohen modele të përqendruara të mendimit, qëndrime dhe paragjykime.

Lënda e gjeografisë ka për objekt studimi njohjen, të kuptuarit dhe përgatitjen në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me njeriun dhe mjedisin e tij rrethues. Studimi i saj forcon perceptimin e nxënësve ndaj hapësirës dhe krijon një kuadër reference për të njohur vende dhe sipërfaqe të ndryshme, si dhe vendndodhjen e tyre, gjë që ndikon në zhvillimin e aftësisë të ta për të kuptuar lidhjen, kontekstin dhe tërësinë integrale në kushtet e mbijetesës, të përdorimit të burimeve dhe ndikimin e mjedisit, si dhe aftësinë për të kuptuar mundësitë dhe për të vlerësuar pasojat e alternativave të ndryshme vepruese.

Lënda ka, gjithashtu, për qëllim të zhvillojë jo vetëm njohuritë për kushtet natyrore të rajoneve të ndryshme, karakteristikat e tyre shoqërore dhe ekonomike, por edhe kushtet e ndryshme të jetesës së njerëzve në shkallë vendi, rajoni apo globi. Kështu ndihmohet nxënësi për të kuptuar më mirë kulturat e ndryshme, vlerat e mënyrat e ndryshme të jetesës dhe t'i respektojë ato.

Problemet që kanë të bëjnë me shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve, si dhe ato që kanë të bëjnë me njeriun dhe mjedisin, shqyrtohen në kurrikulin e gjeografisë mbi bazën e vepimit të një serë faktorësh dhe qëndrimesh. Mësimi i gjeografisë na jep mjetet që nevojiten për të analizuar ndërveprimin njeri–natyrë, duke formuar, gjithashtu, aftësitë dhe vlerat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit të përbashkët dhe përdorimin racional të burimeve me qëllim që të lehtësohen zhvillimet afatgjata.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në mësimdhënien e gjeografisë shkolla 9-vjeçare duhet të sigurojë që nxënësit:

- të rrisin njohuritë e tyre rreth kushteve të jetesës së njeriut, rreth natyrës dhe shoqërisë, si dhe për marrëdhëniet e brendshme ndërmjet tyre në pjesë të ndryshme të botës;
- të zhvillojnë dijet për proceset e natyrës, të cilat, në kushte afatshkurtra dhe afatgjata, formojnë dhe ndryshojnë peizazhin natyror, si dhe të kuptojnë si njeriu ndikon mbi këto procese duke vlerësuar dhe pasojat që rrjedhin prej tyre;
- të zhvillojnë dijet e tyre rreth mënyrës si ka ndryshuar peizazhi gjatë zhvillimeve të ndryshme historike, politike, ekonomike e kulturore;
- të zhvillojnë aftësinë e tyre për të reflektuar dhe për t'u pozicionuar ndaj alternativave të ndryshme, të bazuara në mendimin ekologjik në lidhje me përdorimin e burimeve;
- të zhvillojnë njohuritë e tyre rreth veprimtarive të ndryshme ekonomike, teknike, shoqërore e kulturore të njeriut, të kuptojnë si lidhen ato së bashku në

- shkallë lokale, vendi dhe rajoni, si dhe të jenë në gjendje të gjykojnë e të nxjerrin përfundime për pasojat e një marrëdhënieje të tillë;
- të zhvillojnë aftësitë e tyre për të formuluar dhe për të punuar me probleme që kanë të bëjnë me çështjet e ndryshme mjedisore, lokale dhe globale;
 - të zhvillojnë aftësinë e tyre për të bërë përgjithësime, për të shpjeguar dhe për të dhënë arsyet për mendimet dhe përfundimet e tyre.

OBJEKTIVAT PËRFUNDIMTARË

Në fund të klasës IX nxënësit duhet:

- të marrin njohuritë bazë në gjeografi për të mbajtur qëndrim sesi veprimet e njeriut ndikojnë mbi mjedisin;
- të kuptojnë se çfarë është një hartë dhe si mund të përdoret ajo; të njohin globin dhe të dinë vendndodhjen e vendeve dhe të sipërfaqeve të ndryshme, si dhe të jenë në gjendje të vlerësojnë largësinë ndërmjet tyre;
- të njihen me disa nga forcat që kanë formuar sipërfaqen e tokës dhe që janë duke ndryshuar peizazhin, dhe, në bazë të kësaj dhe të vëzhgimeve e përvojave të tyre nga mjedisi përreth, të jenë në gjendje të japin shembuj për këto ndryshime;
- të marrin njohuri rreth disa karakteristikave themelore të peizazheve të tipave të ndryshëm të vendit tonë dhe të përshkruajnë si njerëzit në të kaluarën dhe aktualisht jetojnë dhe punojnë në mjedise të ndryshme;
- të përvetësojnë nëpërmjet vëzhgimeve dhe matjeve të tyre kuptimin e koncepteve të tilla, si: mot, klimë, stinët e vitit, mjedis jetësor etj., si dhe të jenë në gjendje të tregojnë si ndryshojnë ato në vende e rajone të ndryshme.

KLASA VI: GJEOGRAFIA FIZIKE

Objektivat e përmbajtjes

Në klasën e gjashtë, përmbajtja e lëndës do të përqendrohet në kuptimin dhe përdorimin e koncepteve bazë të kërkimit gjeografik, si dhe të modeleve fizike dhe ndikimit të tyre në veprimtarinë njerëzore. Nxënësit do të kuptojnë thelbin e konceptit për modelet si një nga konceptet fundamentale të gjeografisë. Do të njihen, gjithashtu, me resurset e ndryshme, mënyrën e përdorimit të tyre, si dhe rolin e mjedisit në këtë përdorim. Ata do të thellohen në të kuptuarit e ndikimit dhe të rolit të sotëm të teknologjisë në drejtim të shfrytëzimit të resurseve natyrore.

Progami sintetik

35 javë x 2 orë	70 orë
Njohuri të reja	48 orë
Punë praktike	10 orë
Përsëritje dhe në dispozicion	12 orë

Programi analitik

Struktura e përmbajtjes lëndore përfshin këto fusha:

1. Konceptet bazë të kërkimit gjeografik
2. Modelet në gjeografinë fizike
3. Resurset natyrore

1. Konceptet bazë të kërkimit gjeografik (15 orë teori, 3 orë punë praktike)

OBJEKTIVAT PËRFUNDIMTARË

Në përfundim të klasës VI nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të demonstrojnë përvetësimin e njohurive dhe të shprehive që lidhen me kërkimet gjeografike;
- të përdorin pesë konceptet bazë të gjeografisë (lokalizimi/ vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi, zhvillimi) gjatë kërkimeve të tyre;
- të përdorin paraqitjet e ndryshme të gjeografisë, mjetet dhe teknologjitë për të komunikuar me informacionin gjeografik.

OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

A. Të kuptuarit e koncepteve

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të identifikojnë konceptet që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: lokalizimi/ vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi dhe zhvillimi;
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit vend/lokalizim (p.sh., një vend përcaktohet nga karakteristikat e përbashkëta fizike dhe humane, ndërsa me lokalizim kuptojmë ku ndodhet një vend dhe çfarë lidhjesh relative ka ai me vendet e tjera);
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit për mjedisin (p.sh., në sistemin e elementeve jetësore dhe jojetësore, njerëzit janë pjesë e elementeve jetësore);
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit për rajonin (p.sh., rajoni është një pjesë e sipërfaqes së tokës që ka karakteristika të njëjta ose të ngjashme dhe që koncepti për rajonin ndihmon për të thjeshtuar idetë komplekse);
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit për ndërveprimin (p.sh., njerëzit e ndryshojnë mjedisin duke e përdorur atë etj.);
- të demonstrojnë kuptimin e konceptit për zhvillimin (qarkullimin, lëvizjen), (p.sh., qarkullimi i njerëzve, mallrave dhe informacioneve, si dhe faktorët që ndikojnë në këtë qarkullim etj.);

B. Zhvillimi i shprehive

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përdorin fjalorin e mësuar (p.sh., dukuri, shpërndarje, ndikim, fakt, opinion, vendndodhje absolute, vendndodhje relative, ndërveprim, rajon) për të përshkruar kërkimet dhe vëzhgimet e tyre;
- të formulojnë pyetje të tipave të ndryshëm për të identifikuar çështjet dhe për të përcaktuar problemet dhe drejtimit e kërkimeve gjeografike;
- të zbulojnë informacionet kryesore nga llojet e shumta të burimeve të drejtpërdrejta (p.sh., intervistat, statistikën, fotografitë ajrore, pamjet satelitore etj.) dhe burimeve jo të drejtpërdrejta të njohurive (p.sh., hartat, diagramet, ilustrimet, materialet e printuara, videot, CD, interneti etj.);
- të analizojnë, të sintetizojnë dhe të vlerësojnë të dhënat nëpërmjet shqyrtimit të një problemi mjedisor duke dhënë edhe zgjidhjet e mundshme;
- të ndërtojnë lloje të shumta grafikësh, hartash, diagramesh dhe modelesh për qëllime të ndryshme mësimore;

- të paraqesin, sipas këndvështrimeve të ndryshme, përfundimet e kërkimeve të tyre për një çështje të caktuar duke përdorur mjetet e medias, paraqitjet gojore, materialet e shkruara, tabela, harta, grafikë etj.

2. Modelet në gjeografinë fizike (28 orë teori, 5 orë punë praktike)

OBJEKTIVAT PËRFUNDIMTARË

Në përfundim të klasës VI nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të shpjegojnë pse dhe sa të përdorshme janë modelet në studimet gjeografike;
- të identifikojnë dhe të shpjegojnë modelet e ndryshme në gjeografinë fizike;
- të demonstrojnë të kuptuarit e ndikimit të modeleve fizike në veprimtarinë njerëzore.

OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

A. Të kuptuarit e koncepteve

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të njohin modelin si një koncept të rëndësishëm të gjeografisë (p.sh., lokalizimi i vullkaneve përgjatë bregut të Oqeanit Paqësor);
- të identifikojnë dhe të shpjegojnë si dhe sa përdoren format e tokës për të përshkruar rajonet;
- të identifikojnë dhe të përshkruajnë modelet botërore të formave të tokës (p.sh., vendndodhjen e vargjeve malore gjatë brigjeve perëndimore të Amerikës së Veriut dhe të Jugut etj.);
- të identifikojnë dhe të përshkruajnë modelet klimatike të botës;
- të demonstrojnë të kuptuarit e arsyeve që modelet e klimës rrjedhin nga ndërveprimi i faktorëve të ndryshëm: gjerësia gjeografike, lartësia mbi nivelin e detit, sistemi botëror i erërave, masat ajrore, largësia nga deti, rrymat oqeanike etj.;
- të identifikojnë nëpërmjet vëzhgimit pasojat e dukurive natyrore (p.sh., tornadot, vullaknet, tërmetet, tajfunet) për njerëzit dhe mjedisin;
- të demonstrojnë të kuptuarit e arsyeve që modelet e vegjetacionit natyror rrjedhin nga ndërveprimi i faktorëve të ndryshëm: temperatura, reshjet, tipat e dherave, mundësitë e të ushqyerit etj.;
- të identifikojnë sistemet e mëdha lumore të botës (p.sh., Amazona, Nili) dhe të përshkruajnë modelet e kanaleve të tyre të kullimit;
- të përshkruajnë lidhjen ndërmjet modeleve fizike dhe tipave të prodhimeve bujqësore (p.sh., format e tokës: fushat/drithërat; klima: tropikale/ bananet etj.);
- të demonstrojnë të kuptuarit e tre tipave të bujqësisë (mjet jetese, tregtare, e specilizuar), si dhe lidhjet e tyre me klimën, dherat etj.;
- të identifikojnë gjashtë faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë tregtare: vendndodhja, klima, lënda e parë, tregu, puna dhe transporti.

B. Zhvillimi i shprehive

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përdorin fjalorin e mësuar, përfshirë këtu terminologjinë e saktë gjeografike

(p.sh., model, klasifikim grafik i klimës, gjerësi, lartësi etj.) për të përshkruar kërkimet dhe vëzhgimet e tyre;

- të formulojnë pyetje të tipave të ndryshëm për të drejtuar kërkimet në lidhje me studimin e çështjeve të modeleve fizike;
- të zbulojnë informacionet kryesore në lidhje me modelet fizike nga llojet e shumta të burimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të njohurive gjeografike;
- të analizojnë, të sintetizojnë dhe të vlerësojnë të dhënat (p.sh., në lidhje me modelet bujqësore, modelet e formave të tokës etj.);
- të ndërtojnë lloje të shumta grafikësh, hartash, diagramesh dhe modelesh për të organizuar informacionet (p.sh., sistemi lumor dhe hartat e shpërndarjes së reshjeve etj.);
- të paraqesin përfundimet e kërkimeve të tyre për qëllime të veçanta duke përdorur mjetet e medias, paraqitjet gojore ose të shkruara, vizatimet, tabelat, grafikët dhe diagramet etj.;
- të identifikojnë modelet në gjeografinë fizike duke përdorur hartat tematike;
- të ndërtojnë dhe të interpretojnë grafikë klimatikë;
- të vizatojnë diagrame me prerje tërthore (p.sh., për format e tokës, profilet e lumenjve etj.).

3. Resurset natyrore (5 orë teori, 2 orë punë praktike)

OBJEKTIVAT PËRFUNDIMTARË

Në përfundim të klasës VI nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë rolin dhe ndihmesën konkrete të resurseve natyrore për zhvillimin ekonomik;
- të identifikojnë faktorët që ndikojnë në vlerësimin dhe përdorimin e resurseve natyrore (p.sh., oferta dhe kërkesa, teknologjia etj.);
- të kuptojnë si dhe sa ndikon veprimtaria humane (p.sh., sistemi i kanalizimit etj.) tek njeriu dhe mjedisi.

OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

A. Të kuptuarit e koncepteve

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë që njerëzit i përdorin resurset e përsëritshme dhe të papërsëritshme në shumë mënyra dhe gjithnjë në shërbim të plotësimin të nevojave të tyre;
- të identifikojnë modelet që ekzistojnë në shpërndarjen dhe përdorimin e resurseve natyrore në të gjithë botën;
- të demonstrojnë të kuptuarit e rolit dhe të ndikimit të teknologjisë në drejtim të resurseve natyrore (p.sh., në lidhje me zbulimin, nxjerrjen, përpunimin dhe shitblerjen);
- të demonstrojnë kuptimin e thelbit të konceptit për zhvillimin e pandërprerë dhe veprimin e tij në mjedis;
- të përshkruajnë ndikimin e resurseve natyrore në një vend ose rajon të caktuar;
- të paraqesin dhe të mbrojnë sipas këndvështrimit të tyre mënyrën e përdorimit të një burimi natyror.

B. Zhvillimi i shprehive

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përdorin saktë fjalorin dhe terminologjinë gjeografike të mësuar (p.sh., resurs, zhvillimi i pandërprerë etj.) për të përshkruar kërkimet dhe vëzhgimet e tyre;
- të formulojnë pyetje të tipave të ndryshëm për të identifikuar çështjet dhe për të qartësuar problemet e temave studimore (p.sh., ndikimi i teknologjisë në drejtim të resurseve natyrore etj.);
- të zbulojnë dhe të regjistrojnë informacionet kryesore nga llojet e shumta të burimeve të drejtpërdrejta të njohurive (p.sh., intervistat, statistikën, studimet gjeografike) dhe jo të drejtpërdrejta (p.sh., hartat, ilustrimet, diagramet, materialet e printuara, CD, interneti etj.);
- të analizojnë, të sintetizojnë dhe të vlerësojnë të dhënat (p.sh., në lidhje me modelet e shpërndarjes dhe të përdorimit të resurseve natyrore etj.);
- të ndërtojnë grafikë, harta, diagrame dhe modele të ndryshme për të organizuar informacionet (p.sh., ndërtimi i një grafiku për të demonstruar thelbin e konceptit të ofertës dhe të kërkesës);
- të paraqesin përfundimet e kërkimeve dhe të vëzhgimeve të tyre duke përdorur mjetet e medias, raportimet gojore ose të shkruara, vizatimet, tabelat me të dhëna statistikore, diagramet etj.;
- të tregojnë në hartë vendndodhjen e resurseve natyrore të Shqipërisë;
- të identifikojnë modelet e resurseve natyrore duke përdorur hartat tematike (p.sh., vendndodhjet e mineraleve të çmuara etj.).

FUSHA. SHKENCAT SHOQËRORE

Fusha e shkencave shoqërore në arsimin parauniversitar përfshin lëndët: histori, gjeografi dhe edukatë shoqërore.

Në këtë fushë përmbajtja mësimore e përbashkët është ndërtuar sipas një këndvështrimi studimor shoqëror. Kjo përmbajtje së bashku me përmbajtjet e lëndëve të ndryshme të fushës shikohen si një e tërë, pjesët e të cilës duhet të mbështesin dhe të plotësojnë njëra-tjetrën. Në këtë kuptim, synimet e ndryshme lëndore përfaqësojnë së bashku politikën kombëtare për arsimimin e nxënësve në fushën e shkencave shoqërore.

Mjaft nga njohuritë, shprehitë dhe vlerat e ndryshme të shkencave shoqërore janë të lidhura me përmbajtjet e lëndëve të tjera shkollore.

Detyra kryesore e shkencave shoqërore është të zhvillojë njohuritë e nxënësve rreth njeriut dhe veprimeve të tij, si edhe rreth ndryshimeve të natyrës e të shoqërisë në vende të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme.

Është një kusht paraprak i domosdoshëm për një shoqëri dinamike demokratike që antarët e saj të njihen me vlera të caktuara demokratike dhe t'i mbështesin ato. Çdo brez i ri ka nevojë të mësojë vlerat e pjesëmarrjes në proceset demokratike dhe vlerësimin e rregullave demokratike që drejtojnë sektorë të ndryshëm të shoqërisë sonë. Të gjithë nxënësit janë anëtarë të shoqërisë dhe në kohën e duhur do të marrin pjesë, në mënyra të ndryshme, në formimin dhe drejtimin e saj. Studimet shoqërore synojnë t'i përgatisin nxënësit për detyra të ndryshme në shoqëri, duke i pajisur ata me dije, besim në vlerat e tyre dhe me dëshirën për të ndërmarrë detyra për të mirën e përgjithshme. Këto synime arrihen në bashkëveprim të ngushtë me shoqërinë e gjerë jashtë shkolle.

Njohja e së kaluarës i lidh njerëzit së bashku, përmes shekujve. Këto njohuri nevojitet për të qenë të aftë të kuptojmë dhe të vlerësojmë kohën tonë dhe të planifikojmë të ardhmen. Studimet shoqërore tregojnë si njerëzit përmes bashkëveprimit të tyre me natyrën dhe me njëri-tjetrin kanë zhvilluar lloje të ndryshme të jetës shoqërore dhe forma të shoqërisë. Zhvillimi i qëndrimeve të caktuara të përgjegjshme ndaj shoqërisë sonë, të të kaluarës dhe të të tashmes, është një synim i rëndësishëm i shkencave shoqërore. Bashkëveprimi ndërmjet ekonomisë, ekologjisë dhe teknologjisë paraqet sfida të mëdha në shoqërinë e sotme. Studimet shoqërore synojnë të zhvillojnë njëherazi logjikën e nxënësve, interesin e bashkëveprimit ndërmjet shoqërisë dhe natyrës dhe të lartësojnë ndërgjegjësimin e njerëzve për kushtet dhe standardet e jetesës së tyre.

Struktura e fushës

Në planin shkollor të arsimit të detyruar, objektivat dhe elementet kryesore lëndore organizohen dhe paraqiten në lëndët historike, gjeografi dhe edukatë shoqërore.

Studimi i historisë fillon në klasën IV të CF dhe vazhdon pa ndërprerje deri në klasën IX të CMU. Në përmbajtjen e saj kjo lëndë trajton dimensionet kronologjike, shqyrton pikëpamje të ndryshme të njerëzve dhe forma të ndryshme të shoqërisë përmes shekujve, si dhe forcat shtytëse që nxisin zhvillimet shoqërore.

Gjeografia, që ka të njëjtën shtrirje me historinë, trajton hapësirën dhe ndryshimet në hapësirë, lokalizimin dhe përhapjen në sipërfaqen e tokës të dukurive e proceseve natyrore dhe të krijuara nga njeriu. Gjeografia shqyrton dhe shpjegon shoqërinë ashtu sikurse ajo paraqitet në bashkëveprimin e njerëzve me natyrën, studion kushtet e jetesës në botë, mënyrat e të jetuarit dhe standardet e jetesës.

Edukata shoqërore zhvillohet në të gjitha klasat e arsimit të detyruar. Kjo lëndë trajton, në përshtatje me moshën e nxënësve, edukimin për të drejtat e nxënësve, edukimin me aftësitë për jetën, edukimin për paqen, edukimin global, edukimin shoqëror, edukimin ndërkulturor, edukimin ekonomik dhe edukimin për qytetarinë demokratike. Ajo tregon pse shoqëria ka nevojë për ligje dhe rregulla, organizim dhe qeverisje që të funksionojë. Lënda e edukatës shoqërore studion bashkëveprimin njerëzor, të drejtat dhe detyrimet, sfidat me të cilat përballen individët si pjesëmarrës të komuniteteve të ndryshme.

Në shkollën fillore, shkencat shoqërore shfaqen si pjesë të integruara të temave më të gjera kroskurrikulare. Më vonë, të tria lëndët dalin më qartë si disiplina të veçanta, ndonëse studimet në shkencat shoqërore synojnë gjatë gjithë periudhës të ndërthurin historinë, gjeografinë dhe edukatën shoqërore në një tablo të vetme.

Metodat e përdorura në lëndët e shkencave shoqërore sigurojnë që nxënësit të kenë mundësi të fitojnë gjykim të pavarur, të zhvillojnë aftësi përkatëse dhe aftësitë për të bashkëvepruar me të tjerët, si dhe t'i përgatisin ata për të ndërmarrë veprime të frytshme. Puna e tyre të nxisë kuriozitetin dhe aftësitë për të bërë pyetje. Materiale me vlerë mund të gjenden në burime historike, gjeografike apo me karakter shoqëror, si dhe në tregime e lloje të tjera treguese. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të mësojnë duke bërë pyetje dhe duke përdorur pyetësorë, duke zhvilluar intervista, duke kryer vëzhgime sistematike e duke grumbulluar të dhëna. Një tjetër synim është të zhvillojë aftësinë e nxënësve për të lexuar, për të interpretuar dhe për të përdorur hartat. Nxënësit duhet të aftësohen në përdorimin e tabelave dhe të grafikëve. Bibliotekat e shkollave janë burime shumë të vlefshme të informacionit në studimin e lëndëve shoqërore. Nxënësve duhet t'u jepet hapësira e nevojshme që ata të mësohen të

zhvillojnë diskutime, të zhvillojnë analiza kritike, konkurse, ekskursione, punë të pavarura dhe të provojnë si të organizojnë punën në bashkëveprim me të tjerët. Loja në role dhe teknika të tjera që lidhen me dramën, udhëtimet imagjinare etj., mundësojnë përdorimin e teknikave të dobishme në procesin e të mësuarit të këtyre lëndëve.

Në nivelin fillestar (klasa I-III e CF), nxënësit të përqendrohen në mjediset e tyre lokale, të eksplorojnë kushtet dhe dukuritë lokale. Ata do të dëgjojnë dhe do të tregojnë histori dhe loja do të jetë një burim i rëndësishëm i të mësuarit. Nxënësit duhet të vizitohen në shkolla nga njerëz që mund t'u tregojnë atyre për ngjarje dhe përvoja të veçanta. Një numër metodash të përdorura në nivelin fillestar do të vazhdojnë të zbatohen në fazën e ndërmjetme (klasa IV-V e CF). Nxënësit do të kryejnë vëzhgime më sistematike dhe atyre do t'u kërkohet të regjistrojnë dhe të organizojnë vetë të dhënat e tyre. Ata, gjithashtu, do të nxiten të gjykojnë dhe të shpjegojnë përfundimet e vëzhgimeve të ndryshme dhe të përdorin metoda të thjeshta për grumbullimi e informacionit, si dhe të kenë mundësi të lexojnë më shumë dhe të përfshihen më gjerësisht në veprimtari bashkëvepruese.

Në CMU nxënësve do t'u kërkohet të formulojnë probleme, të analizojnë dhe të interpretojnë burime të ndryshme informacioni dhe të shpjegojnë e të vlerësojnë. Nxënësit do të praktikojnë diskutimin dhe do të provojnë vlerat e kompromisit. Ata do të provojnë, gjithashtu, aspekte të rëndësishme të demokracisë praktike në jetën e shkollës së tyre. Nxënësit duhet të kenë hapësirë për t'i caktuar vetes objektiva, të gjejnë mënyra për arritjen e këtyre objektivave dhe të kenë liri për të mbajtur qëndrimin e tyre ndaj çështjeve të kontestueshme dhe çështjeve që lidhen me vlerat.

Objektivat e përgjithshëm të fushës

Në mësimdhënien e shkencave shoqërore shkolla duhet të sigurojë që nxënësit:

- të shqyrtojnë dhe të kuptojnë marrëdhëniet dhe kontekstet shoqërore aktuale dhe të kaluara, si edhe të mbajnë qëndrim rreth asaj sesi zgjedhjet që njerëzit bëjnë sot, mund ndikojnë në të ardhmen;
- të kuptojnë konceptet themelore, të cilat bëjnë të mundur kërkimin në mënyrë të pavarur, si dhe të përdorin njohuritë për çështjet shoqërore;
- të zhvillojnë aftësinë e tyre për të përdorur burime të ndryshme të informacionit, si dhe të mbajnë një qëndrim kritik për to;
- të zhvillojnë besimin në aftësitë e tyre për të pasur ndikim dhe dëshirë për të mbrojtur vlerat demokratike, si dhe për t'u njohur me të drejtat dhe detyrimet si qytetarë të një shoqërie demokratike;
- të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën e shoqërisë dhe zhvillimin e saj, si edhe të jenë përgjegjës për mjedisin ku jetojnë;
- të marrin informacione rreth mënyrës sesi kushtet natyrore dhe materiale, si dhe idetë e pikëpamjet kryesore për jetën, formojnë dhe kanë formuar shoqërinë;
- të zhvillojnë aftësitë e të kuptuarit të pikëpamjeve themelore ekzistuese dhe etike për shoqërinë dhe të jenë në gjendje t'i përdorin ato për të formuluar pikëpamjet e veta;
- të zhvillojnë dijet dhe aftësitë e tyre për ta vendosur veten në mënyra të ndryshme jetese dhe të kuptojnë arsyet për ndryshimet në kohë dhe hapësirë, si dhe rreth asaj që është e përbashkët në kultura të ndryshme;

- të zhvillojnë respektin për pikëpamjet e personave të tjerë duke vënë re dhe duke e distancuar veten e tyre nga veprimtaritë të cilat përfshijnë shtypjen dhe dhunën ndaj të tjerëve;
- ta bëjnë zakon të veprimeve të tyre marrjen parasysh të vlerave të barabarta dhe të drejtat e gjithësecilit, pavarësisht nga gjinia, klasa apo përkatësia etnike;
- të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar pasojat e pikëpamjeve dhe të veprimeve të tyre dhe të të tjerëve, si dhe të zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar sfidat lokale, kombëtare dhe globale shoqërore dhe politike;
- të zhvillojnë arsyetimin për kuadrin ekologjik dhe rrugët e ndryshme të ruajtjes dhe të përdorimit të burimeve;
- të zhvillojnë të kuptuarit e mënyrës si veprimtaritë dhe kulturat pasqyrojnë edhe ndikime të tjera, si, për shembull, nga arti, letërsia dhe muzika.

KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË GJEOGRAFISË PËR KLASËN E GJASHTË

Përveç kërkesave që parashtrohen në programin zyrtar të lëndës “GJEOGRAFI” për klasën e gjashtë të ciklit të mesëm të ulët, puna e institucioneve dhe e grupeve të autorëve që do të marrin përsipër hartimin e teksteve të përqendrohet edhe në plotësimin e disa kriterëve të tjera që kanë të bëjnë si me këndvështrime të përgjithshme, ashtu edhe ato më specifike shkencore e didaktike, të cilat do të paraqiten në vijim.

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Teksti shkollor ka qenë dhe vazhdon të jetë një instrument me vlerë i procesit mësimor. Për këtë arsye, tekstet e nxënësit të paraqesin veçori si në trajtimet konceptuale, ashtu edhe në formën e paraqitjes.

Hartimi i teksteve është proces. Ai duhet:

- ◆ Të bazohet dhe të jetë në koherencë të plotë me paketën zyrtare të lëndës shkollore dhe në veçanti me programin e reformuar dhe standardet lëndore;
- ◆ Të marrë parasysh përvojën e deritanishme të shkollës sonë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera;
- ◆ Të mbështetet në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore, duke përdorur metoda të ndryshme për tërheqjen e mendimit të nxënësve dhe mësuesve në këtë nivel;
- ◆ Të respektojë veçoritë e zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës;
- ◆ Të synojë nxitjen e ideve të reja në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve në lëndën e gjeografisë;
- ◆ Të synojë realizimin e një dokumenti fleksibël, që i lë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike.

II. KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË LËNDËS SË GJEOGRAFISË

Teksti i lëndës së gjeografisë, synon, ndër të tjera, të krijojë në klasë, në miniaturë, një mjedis të përshtatshëm dhe motivues për përvetësimin nga nxënësit të njohurive gjeografike. Ai duhet të krijojë mundësinë jo vetëm të bashkëpunimit krijues të nxënësve me njëri-tjetrin, por edhe të bashkëpunimit ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, madje më gjerë, bashkëpunimin e mjedisit shkollor me mjedisin jashtë shkollës.

Teksti “GJEOGRAFI 6” duhet të jetë në përputhje me programin konkret të miratuar nga MASH. Ai duhet të përmbushë të gjithë objektivat mësimorë e pedagogjike që përmbahen në të. Në këtë mënyrë, teksti duhet t’u përmbahet

qëllimeve të sistemit arsimor, në përgjithësi, dhe të programit, në mënyrë të veçantë. Kjo gjë nënkupton mbajtjen parasysh të qëllimeve në dy nivele:

1. të qëllimeve të shprehura hapur në program. Kjo do të thotë që në tekst duhet të përfshihen ato informacione dhe të mundësohen ato veprimtari që synojnë të arrihet qëllimi i shprehur në program;
2. të qëllimeve të nënkuptuara. Kjo do të thotë që autorët e teksteve duhet të studiojnë dhe të zbulojnë atë sistem vlerash në të cilat mbështetet një sistem arsimor demokratik. Teksti nga ana e tij, si i tërë, të mundësojë realizimin e qëllimeve të tilla të cilat në shumë raste janë edhe themelore.

Teksti nuk është përkthim i programit, i cili ka karakter sa detyrues aq edhe rekomandues. Këtë autorët duhet ta mbajnë parasysh. Këta të fundit duke patur një konceptim të qartë të procesit mësimor dhe duke patur perceptimin e tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor progresi në mësimdhënien e lëndës së gjeografisë. Në këtë drejtim, autorët mund të shfrytëzojnë:

- ◆ Hapësirat dhe lirshmërinë e programit (orët në dispozicion ose përsëritjet);
- ◆ Aparatin pedagogjik të tekstit, i cili më shumë se çdo tjetër kufizon ose zgjeron mundësitë e përvetësimit të objektivave të lëndës.

Teksti duhet të japë mundësi të sjellë në klasë shembuj konkretë nga gjendja konkrete ekonomike, fizike e shoqërore e mjediseve gjeografike.

Nga pikëpamja pedagogjike, teksti të mundësojë realizimin e objektivave në fushën e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve. Kjo do të thotë që teksti duhet të ofrojë, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit, krijimin e situatave mësimore që mundësojnë realizimin e objektivave të mësipërm. Këtu duhet të kujtojmë se veprimtaritë praktike nuk mund të shihen të ndara nga njohuritë gjeografike. Për këtë arsye autori (autorët) e tekstit duhet të parashikojë ato njohuri që mundësojnë realizimin në tërësinë e tyre të synimeve dhe të objektivave të lëndës.

Sistemi i pyetjeve në fund të njësisë mësimore (autorët mund të përdorin edhe forma të tjera), të ofrojë mundësinë që nxënësit:

- Në mënyrë të pavarur të përvetësojë informacionin e tekstit;
- Të dallojnë atë çka është thelbësore nga ajo që nuk është e tillë, në varësi të objektivave të njësisë mësimore dhe të objektivave të programit;
- Të krijojnë mendimin dhe qëndrimet e tyre të pavarura, të mbështetura me argumente, si dhe të pranojnë, të respektojnë dhe të marrin parasysh argumentet e të tjerëve;

Mësuesit :

- Të zgjedhin metodat ndërvepruese më të përshtatshme për realizimin e objektivave të lëndës së gjeografisë;
- Të planifikojnë më mirë orën mësimore;
- Të mundësojnë vënien e nxënësve në kushte të barabarta të nxëni;
- Të mundësojnë nxënësit të përqendrohen në çështjet kryesore të temës mësimore;
- Të mundësojnë nxënësit të shfrytëzojnë njohuritë e tyre paraprake ose të përvetësuar gjatë procesit mësimor që janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe shprehive të reja;
- Të vlerësojnë realizimin e objektivave të njësive mësimore dhe nivelet e përvetësimit të tyre nga nxënësit etj.

- ◆ Teksti të përmbajë mësim ose struktura mësimi të qarta, në formën e njësive mësimore, për të arritur objektiva të qartë mësimorë në përputhje me programin dhe me standardet lëndore.
- ◆ Po kështu, në tekst mund të shfrytëzohet ose të nxitet edhe mundësia e marrjes së informacioneve të caktuara shtesë nga burime të tjera informacioni (atlase, harta, foto dhe albume gjeografike etj.), gjë që do të bënte tekstin ose njësinë mësimore më të përshtatshme, më tërheqëse dhe më pak monotone, duke rritur edhe mundësitë e punës së pavarur individuale, kërkimore të nxënësve.
- ◆ Gjuha e teksteve të jetë e thjeshtë, e kuptueshme, e pangarkuar me terma e terminologji në gjuhë të huaja ose që bartin kuptime të ndryshme.
- ◆ Kur në tekst përdoren ilustrime, ato të bartin vlera kuptimore dhe emocionale që lidhen ngushtë me motivimin e nxënësve, me përmbajtjen e njësive mësimore ose me objektiva të tjerë të programit.
- ◆ Nga pikëpamja sasiore, autorët e teksteve të shmangin informacionet e tepërta, të përsëritura etj., që shpesh krijojnë mbingarkesë tek nxënësit, të cilët jo gjithmonë janë në gjendje të dallojnë informacionin kryesor nga ai që nuk është i tillë në raport me kërkesat e programit ose të njësive mësimore.
- ◆ Autorët të bëjnë kujdes që të mos krijojnë mbingarkesë edhe në dhënien e koncepteve. Mbingarkesa krijohet jo vetëm nga numri i madh i koncepteve që jepen në një njësi mësimore, por edhe nga pamundësia e sqarimit në kushtet e kufizimit sasior (informacionit) dhe kohor të njësive mësimore. Informacionet shtesë (ilustrimet, hartat, fotot, tekstet, grafikët etj.) t'i shërbejnë sqarimit më të mirë të koncepteve.
- ◆ Njësia mësimore e tekstit të ketë një strukturë që të lejojë përmbushjen e shërbimeve të tij, si dhe pasqyrimin e veçorive të përmbajtjes së temave të veçanta. Njohuritë gjeografike të jepen duku u nisur nga veprimtaria praktike e nxënësit, sidomos për njohjen e vendbanimit e të mjedisit gjeografik përreth.
- ◆ Struktura e ndarjeve të tekstit, si dhe struktura e njësive mësimore të tekstit (p.sh., tema) të jenë të njësuar gjatë gjithë tekstit.
- ◆ Faqosja e elementeve të ndarjeve mësimore (titujve, teksteve, figurave, pyetësorit, detyrave, ushtrimeve etj.) të jetë tërheqës dhe i mbështetur në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës, në përgjithësi, dhe të temës, në veçanti.
- ◆ Përdorimi i hapësirave, nënvizimeve, qartësimeve, ngjyrave etj., të jetë në raport të drejtë dhe në shërbim të çështjes që trajtohet.